



|   |               |
|---|---------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVA  |               |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |               |
| Dep.<br>Dep.<br>Dep.  | DPKI          |
| Nr. i faq<br>Proj. stranska<br>Nr. pages  | 03            |
| Nr. Prot<br>Si. Prot<br>Prot. No.   | 06-01/3640/22 |
| Date<br>Datum<br>Date   | 26-08-2022    |
| PRISHTINE   |               |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE**  
**AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullores nr. 01/2018 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Rregullores Nr.01/2014 dhe Rregullores Nr.01/2017 ,Të Punës Së Agjencisë kundër Korrupsionit, nenit 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 19.08.2022 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr.DPKI-06-2966/22 për z. Kushtrim Brahimaj, Menaxher i burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për konflikt të Interesit lidhur me vendimmarrjen e procesit të rekrutimit dhe punësimit për pozitën “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm”.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli, Nr.DPKI-06-2966/22 që për trajtim ka pasur zyrtarin Kushtrim Brahimaj, Menaxher i burimeve Njerëzore në komunën e Gjakovës,**

Inicimi i këtij rasti është bërë pas kërkesës nga një palë e tretë, ku është kërkuar vlerësim të situatës së konflikt të interesit për zyrtarin, Kushtrim Brahimaj, Menaxher i burimeve njerëzore në Komunën e Gjakovës, duke qenë se të gjitha konkuret publike i shpallën përmes kësaj zyre, së fundmi, në pozitën ‘Specialist i Administrimit të Përgjithshëm’, në vendin e dytë është përzgjedhur personi S.B, që është motra e të lartcekurit, Kushtrim Brahimaj.

Edhe pse në shpalljen e këtij konkursi, Kushtrim Brahimaj, është tërhequr, dyshimi i jonë për konflikt të mundshëm interesi është sepse në fund, si udhëheqës i Burimeve Njerëzore, i bie që Kushtrim Brahimaj, të nënshkruaj kontratën e punës për motrën e tij, S. B., prandaj, kërkojmë që të na informoni a kemi të bëjmë në këtë rast me konflikt interesi.





Mbi bazën e këtyre informacioneve Agjencia kundër Korrupsionit, tash(Agjencia Për Parandalimin e Korrupsionit),ka zhvilluar procedurën e paraparë për vlerësimin e situatës së mundshme të konfliktit të interesit, sipas procedurës kemi kërkuar nga Komuna e Gjakovës, të na siguroj dokumentacionin zyrtar dhe të na njoftoj lidhur procesin e rekrutimit dhe punësimit për pozitën “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me nr.referenc:01-111/01-10881”.

Agjencia kundër Korrupsionit, nga Komuna e Gjakovës ka pranuar informacione nëpërmes shkresës zyrtare me (nr.06-01/3190/22 ) me përgjigjen lidhur procesin e rekrutimit dhe punësimit ku na ka informuar se Komuna e Gjakovës me datë 29.04.2022 kishte publikuar konkursin me numër 01-111/01-10881, grupi Specialist i Administrimit të Përgjithshëm. Në këtë konkurs aplikuan 38 kandidat, prej të cilëve 25 kandidat kishin plotësuar kriteret e konkursit që të vazhdonin tutje në fazën e vlerësimit. Pas vlerësimit të rezultatit nga testi me shkrim dhe intervista, nga ky grup rezultuan 11 kandidat të suksesshëm. Në raport me procedurën e rekrutimit për këtë grup, nuk kishte asnjë ankesë nga kandidatët në asnjërën prej fazave të konkurrimit.

Nga këto informacione dhe shpjegimet e dhëna nga komuna e Gjakovës, lidhur me procesin rekrutimit dhe punësimit për pozitën “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me nr.referenc:01-111/01-10881” si dhe nga shkresat e dosjes lidhur me këtë proces, është vërtetuar se zyrtari Kushtrim Brahimaj, Menaxher i burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, nuk ka marr pjesë në asnjë fazë të këtij procesi, kjo është vërtetuar nga informacionet zyrtare me të cilat dëshmohet se zyrtari Kushtrim Brahimaj, sipas procedurës së paraparë nëpërmes komunikimit zyrtar ka informuar udhëheqësin e drejtpërdrejt në këtë rast kryetarin e Komunës së Gjakovës z.Adrian Gjini, me të cilin ka kërkuar të tërhiqet nga procesi në lidhje me konkursin me numër 01-111/01-10881,pasi që në mënyrë verbale është njoftuar nga disa familjar se mund të jen kandidat në konkursin në fjalë.

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke vepruar sipas përgjegjësisë dhe kompetencave të tij, nëpërmes vendimit nr.01-112/02-11647, për shkak të kërkesës për tërheqje nga procesi zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me nr.referenc:01-111/01-10881”, si dhe për të shmangur konfliktin e mundshëm të interesit, nga menaxheri i burimeve njerëzore, ka caktuar zyrtaren T.K, si zëvendësuese e menaxherit të burimeve njerëzore, që të punoj me kompetenca të plota për përfundimin e procedurave të rekrutimit sipas konkursit nr.referenc:01-111/01-10881”.

Sipas vendimit nr.01-112/02-11126 të datës 29.04.2022, të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Gjakovës, zyrtari Kushtrim Brahimaj, nuk figuron të jetë pjesë e komisionit përzgjedhës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me nr.referenc:01-111/01-10881”, po ashtu as në fazën pas përfundimit të procesit së rekrutimit për pozitën “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm”, zyrtari Kushtrim Brahimaj, nuk ka pas rol vendimmarrës, pasi që edhe kontratën në mes të punëdhënësit dhe të punësuarit në vendin e punës si zyrtar administrativ, në kuadër të Bibliotekës Publike “Ibrahim Rugova”, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, të përzgjedhur nga konkursi në fjalë e ka nënshkruar Kryetari i Komunës së Gjakovës Ardian Gjini, në cilësinë e përfaqësuesit të komunës si punëdhënësi.

Duke u bazuar në të gjitha këto konstatojmë se zyrtari Kushtrim Brahimaj, Menaxher i burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, në bazë të njohurive të tij, ka bërë vetë deklarinimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm të lidhur me vendimmarrjen në çështjen e caktuar, që do mund të bëjë shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe është tërhequr nga vendimmarrja në procedurën e rekrutimit për pozitën “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me nr.referenc:01-111/01-10881 .


Andaj duke u bazuar në gjendjen faktike dhe informacionet në dispozicion, lidhur me këtë rast kemi arritur në përfundim se: nuk ka prova të mjaftueshme që e dëshmojnë situatën e konfliktit të interesit në lidhje me punësimin e S.B, si zyrtar administrativ, në kuadër të Bibliotekës Publike “Ibrahim Rugova”, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës, pasi që zyrtari Kushtrim Brahimaj, i dyshuar për situatë të konfliktit të interesit, është tërhequr nga procesi dhe vendimmarrja, duke vepruar sipas ligjit në fuqi, Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë Për Parandalimin e Korrupsionit



---

Yll Buleshkaj